



## STATUT I SHOQERISE

“Educational Investment and Consultancy” Sh.P.K.

## ARTICLES OF ASSOCIATION OF

“Educational Investment and Consultancy” L.L.C.

*Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.*

*This Articles shall be construed as incorporating the Act of Incorporation of the Company, the organization and functioning of which is regulated herein.*

Sot, me 4 Shtator 2019, personi i mëposhtem:

Today, this 4<sup>th</sup> day of September 2019, the following person:

- Shoqëria “UNIVERSITY OF NEW YORK, TIRANA” SH.P.K., një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS-NIPT K21714002G, me seli në Tiranë, Farke, Selite, Rruga “Kodra e Diellit”, të “University of New York Tirana”, zonë kadastrale nr. 3292, numër pasurie 103/17, e përfaqësuar rregullisht nga Administratori i saj z. **Fatih Cankurt**, shtetas turk, lindur më 15.10.1988 në Hafik / Sivas, Republika e Turqisë, mbajtës i pasaportës me nr. Z00511731, njohës i gjuhës angleze, madhor e me zotësi të plote juridike për të vepruar,

- The company “UNIVERSITY OF NEW YORK, TIRANA” SH.P.K., a limited liability company, duly established and operating under the laws of Albania, registered with the Commercial Register with TIN K21714002G, with legal seat in Tirana, Farke, Selite, Rruga “Kodra e Diellit”, të “University of New York Tirana”, Cadastral area nr. 3292, property no. 103/17, duly represented by its Managing Director **Mr. Fatih Cankurt**, Turkish citizen, born on 15.10.1988 in Hafik / Sivas, Republic of Turkey, holder of the passport with no. Z00511731, having a very good command of English, adult of full legal capacity to act,

në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar, dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miraton këtë Statut si vijon:

in accordance with Law no. 9901, dated 14.4.2008, “On Entrepreneurs and Commercial Companies” and with the applicable legislation of the Republic of Albania, have adopted this Articles of Association, as follows:

Në këtë Statut:

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- “Statut” është ky dokument.

In this Articles:

- “Law” is Law 9901/2008 “On Entrepreneurs and Commercial Companies”, as amended;
- “Articles” is this Articles of Association.

### KREU I

**Themelimi, Emri, Forma Ligjore, Objekti, Kohezgjatja dhe Selia**

#### Neni 1

**Emri, Forma Ligjore dhe Themeluesit**

- 1.1. Sot, themeluesi i mësipërm, ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “*Educational Investment and Consultancy*” L.L.C.
- 1.2. Shoqëria organizohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

#### Neni 2

**Objekti**

### CHAPTER I

**Formation, Name, Legal Form, Scope, Duration and Seat**

#### Article 1

**Name, Legal Form and Founders**

- 1.1. Today the hereinabove mentioned founder has founded a limited liability company with the name “*Educational Investment and Consultancy*” L.L.C.
- 1.2. The company is organized in the form of a limited liability company.

#### Article 2

**Scope of activity**

- 2.1. Shoqëria do të kryejë aktivitetet e mëposhtme:  
*Të hapë, të marrë me qira dhe të blejë institucione të arsimit parashkollor, fillor, të mesëm dhe të arsimit të lartë.*  
*Themelimi dhe blerja e organeve të mediave siç janë faqet arsimore të internetit, zhvillimi, prodhimi dhe botimi i programeve arsimore dhe përmbajtjeve; .*  
*Themelimi dhe blerja e ambienteve të tilla si pensione dhe struktura akomodimi për studentët.*  
*Të hyjë në partneritete me biznese dhe të themelojë biznese për të siguruar të ardhura brenda dhe jashtë vendit.*  
*Të blejë dhe të shesë shoqëri tregtare që veprojnë drejtpërdrejt ose indirekt në fushën e arsimit.*  
*Të hyjë në partneritete me shoqëri tregtare për të zhvilluar aktivitetet në nivel ndërkombëtar.*
- 2.2. Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër tregtare te lejuar nga ligji dhe ne përputhje me lejet dhe licencat e kërkueshme sipas rastit si dhe mund të zotërojë dhe administrojë pasuri të luajtshme e te paluajtshme dhe pjesëmarrje e interesa ne shoqëri te tjera tregtare vendase apo te huaja, pavarësisht objektit te veprimtarisë se tyre tregtare.

**Neni 3  
Kohëzgjatja**

- 3.1. Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e *pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.*

**Neni 4  
Selia**

- 4.1. Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: *Shqipëri, Tiranë, Farke, Selite, Rruga "Kodra e Diellit", te "University of New York Tirana", zonë kadastrale nr. 3292, numër pasurie 103/17.*
- 4.2. Me vendim te Administratorit, Shoqëria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

**KREU II  
Kapitali**

**Neni 5  
Kapitali themeltar**

- 5.1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është *100.000*

- 2.1. The company will conduct the following activities:  
*To open, lease, and acquire pre-school, primary education, secondary education and higher education institutions.*  
*Founding and acquiring media organs such as educational web sites, developing, producing and publishing educational programs and contents.*  
*Founding and acquiring facilities such as pensions and lodgement for students.*  
*To partner with and to establish businesses for providing income domestically and internationally.*  
*To takeover and sell companies acting directly or indirectly in the field of education.*  
*To partner with companies to develop the activities at international level.*
- 2.2. The Company may perform any other commercial activity permitted by the law and in accordance with the requested licenses and permits and is entitled to own and manage movable and immovable properties and participations and interests in other local or foreign commercial companies, regardless of their commercial scope.

**Article 3  
Duration**

- 3.1. The duration of the company will be *unspecified and/or unlimited.*

**Article 4  
Legal Seat**

- 4.1. The legal seat of the company is at the address: *Albania, Tirana, Farke, Selite, Rruga "Kodra e Diellit", te "University of New York Tirana", zonë kadastrale nr. 3292, numër pasurie 103/17.*
- 4.2. Upon resolution of the Administrator, the Company may establish branches and/or representative offices within or outside the Republic of Albania.

**CHAPTER II  
CAPITAL**

**Article 5  
Basic Capital**

- 5.1. The initial basic capital of the company is *100,000*



(njëqind mijë) Lekë dhe zotërohet tërësisht nga themeluesi i vetëm.

Ortaku Themelues Shoqëria "UNIVERSITY OF NEW YORK, TIRANA" Sh.P.K. zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme prej 100.000 lekë që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar fillestar të shoqërisë.

5.2. Kontributi i ortakut themelues është në para.

#### Neni 6

##### Kuotat – Te drejtat dhe detyrimet

- 6.1. Secili ortak do të ketë një numër proporcional votash me vlerën nominale të kuotës së tij.
- 6.2. Titulli i pronësisë së kuotave do të regjistrohet në librin e Ortakeve, që do të mbahet në selinë ligjore të Shoqërisë nën përgjegjësinë e Administratorit ("Libri i Ortakeve").
- 6.3. Libri i Ortakeve do të përmbajë të dhënat e mëposhtme:
  - (i) Identitetin e secilit ortak;
  - (ii) Numrin dhe vlerën e kuotës së mbajtur nga secili ortak;
  - (iii) Datën në të cilën Ortaku fitoi pronësinë mbi kuotën;
  - (iv) Adresën ose selinë e regjistruar të secilit ortak;
  - (v) Të dhëna mbi çdo peng apo barre mbi kuotat.

#### Neni 7

##### Transferimi i Kuotave me Kontrate

- 7.1. Pjesët e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.2. Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen nga një ortak, pas miratimit të dhënë nga ana e Asamblesë së Ortakeve nëpërmjet një vendimi të miratuar me shumicë të zakonshme.

#### Neni 8

##### Zmadhimi i Kapitalit

- 8.1. Kapitali themeltar mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, nëpërmjet emetimit të kuotave të reja ose rritjes së vlerës nominale të atyre ekzistuese ose në çdo formë tjetër të

(one hundred thousand) Albanian Lek and is fully owned by the founding partner. The Founding Partner the Company "UNIVERSITY OF NEW YORK, TIRANA" Sh.P.K. owns 1 (one) quota with total value of 100,000 Albanian Lek that represents 100% (one hundred percent) of the basic initial capital of the company.

5.2. The contribution of the founding partner is in cash.

#### Article 6

##### Quotas - Rights and obligations

- 6.1. Each partner shall have a number of votes proportional to the par value of his quota.
- 6.2. The ownership title to the quotas shall be registered in a Partners' book, to be kept at the legal seat of the Company under the responsibility of the Managing Director (the "Partners' Book").
- 6.3. The Partners' Book shall include the following information:
  - (vi) The identity of each Partner;
  - (vii) The number and value of the quota held by each Partner;
  - (viii) The date on which each Partner acquired ownership;
  - (ix) The address or registered office of each Partner;
  - (x) Details of any lien or encumbrance on the quotas.

#### Article 7

##### Transfer of Quotas by Contract

- 7.1. The company's capital parts and the rights they confer shall be acquired or transferred through: Participation in the share capital of a company; Purchase; Inheritance; Donation; Other means provided by the Law.
- 7.2. The basic capital parts may be transferred from a partner, after approval given by the Assembly of Partners through a resolution approved by simple majority.

#### Article 8

##### Registered Capital Increase

- 8.1. The registered capital may be increased, upon resolution of the General Meeting of Partners, by means of issuance of new quotas or by increasing the nominal value of existing quotas or in any other



parashikuar nga Ligji. Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrimin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtrojne te drejta e tyre te parablerjes brenda 20 (njetzet) diteve, atehere ata do t'i blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuota e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij procesi, i ofrohet çdo pale te trete.

8.2. Kuotat e reja qe do te shlyhen si me para ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per Shoqerite Tregtare.

#### **Neni 9 Zvogelimi i Kapitalit**

9.1. Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

### **KAPITULLI III ORGANET E SHOQERISE**

#### **Neni 10 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve**

10.1. Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte vendimmarrës i Shoqërisë, i cili, veç kompetencave te tjera sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo këtij Statuti, merr vendime për çështjet e mëposhtme te Shoqërisë:

- a. përcaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime te Statutit;
- c. emërimi dhe shkarkimi i Administratoreve;
- d. emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabël te autorizuar;
- e. miratimi i skemës se shpërblimeve për personat e përmendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurisë se Shoqërisë;
- g. shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- h. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar te Shoqërisë;
- i. pjesëtimin dhe anulimin e kuotave;
- j. riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- k. miratimin e rregullave te zbatueshme procedurale te mbledhjeve te saj;

way provided by the Law. For each increase of capital of the Company through the issuance of the new quotas, the Partners shall have a pre-emptive right to subscribe such newly issued quotas. In case more than 1 (one) Partner(s) do exercise their pre-emptive right within 20 (twenty) days, then they shall purchase such quotas proportionate to their respective present shareholdings. Any newly issued quotas not purchased by the Partners during this process, shall be offered to any third parties.

8.2. The newly issued quotas, either payable in cash or in kind, shall be paid in conformity with the respective Resolution for the capital increase and the Companies' Law.

#### **Article 9 Registered Capital Decrease**

9.1. The capital may be decreased, upon resolution of the General Meeting of Partners, in accordance with Companies' Law.

### **CHAPTER III COMPANY'S BODIES**

#### **Article 10 General Meeting of Partners**

10.1. The General Meeting of Partners shall be the supreme body of the Company, which, among other powers conferred by the Companies' Law or this Articles, decides on the following Company's matters:

- (a) Defining business policies;
- (b) Amendments to the Articles of Association;
- (c) Managing Directors' election and dismissal;
- (d) Election and dismissal of independent auditors and liquidators;
- (e) Establishment of remunerations' scheme for the persons mentioned under items c. and d.;
- (f) Approval of annual financial statements and reports of the Company's activity;
- (g) Distribution of annual profits;
- (h) Increase or decrease of the Company's registered capital;
- (i) Division and annulment of quotas;
- (j) Company's reorganization and dissolution;
- (k) Approval of the applicable procedural rules of its meetings;
- (l) Other issues as provided by this Articles of



1. çështje të tjera sipas parashikimeve të bëra prej këtij Statuti.
- 10.2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një here në vit.
- 10.3. Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme mund të dërgohet me shkrim apo e-mail në adresat që secili Ortak do t'i njoftojë me shkrim Shoqërisë me poste të regjistruar. Njoftimi do të konsiderohet se i është dorëzuar Shoqërisë me kalimin e ditës së 10-të pas dërgimit.
- 10.4. Njoftimi për thirrjen e Asamblesë duhet të përcaktojë qartë emrin e Shoqërisë, selinë, datën, kohën dhe vendin e mbledhjes, një përshkrim të hollësishëm të procedurës që duhet të ndiqet nga Ortaket për pjesëmarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyrën e marrjes së dokumenteve dhe projektvendimeve që duhet të vihen në dispozicion të gjithë Ortakeve, po ashtu edhe rendin e ditës, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve të paktën 14 (katërmbëdhjetë) ditë para mbledhjes. Rendi i ditës i njoftuar si më sipër duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve duhet të vendosë për ndryshime të Statutit, teksti përkatës duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.
- 10.5. Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve do të thirret nga Administratoret dhe, kur është e zbatueshme, nga Ortaket.
- 10.6. Një Ortak mund të përfaqësohet në Asamblesë e Përgjithshme të Ortakeve nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë i ndryshëm nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin përkatës autorizues. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 10.7. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind) të kuotave. Në këto raste Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve do të vendosë me shumicën e thjeshtë të votave pjesëmarrëse, veçse nëse përcaktohet ndryshe nga Ligji Tregtar dhe/ose nga dispozitat e këtij Statuti.

Association.

- 10.2. The General Meeting of Partners is convened as provided by the applicable laws or this Articles of Association and at any time it is necessary to safeguard the Company's interests. The General Assembly shall meet at least once per year.
- 10.3. The notice of convocation of the General Assembly may be sent in writing or via e-mail at the addresses that each of the Partners shall notify in writing to the Company via registered mail. The notification shall be considered as sent to the Partners as of the 7<sup>th</sup> day after sending.
- 10.4. The notice of convocation of the Assembly shall clearly indicate Company's name, registered office, the date, time and place of the meeting, a detailed description of the participation and voting procedure to be followed by the Partners, information related to the place and way of receiving the documents and draft-resolutions that should be made available to the Partners, as well as the agenda, and shall be notified to all Partners at least 7 (seven) days prior to the meeting. The agenda, notified as stated hereinabove, should include the proposed resolution for each item. In case the General Meeting of Partners should decide on changes to the Articles of Association, the respective content should be notified along with the agenda.
- 10.5. The General Meeting of Partners shall be convened by the Managing Directors and, when applicable, by the Partners.
- 10.6. A Partner may be represented in the General Meeting of Partners by another Partner or a third person other than the Managing Directors, upon submitting the relevant authorizing deed. The authorization can be issued only for one General Meeting of Partners, which includes also the following meetings to be held with the same agenda.
- 10.7. In case of ordinary decisions, except when the Law provides otherwise, the General Meeting of Partners may only resolve and adopt valid decisions if attended by Partners or representatives of Partners holding more than 75% (seventy five percent) of the registered capital. In such cases, the General Meeting of Partners shall decide by simple majority of the participating votes, unless otherwise provided by the Companies' Law and/or this Articles of Association.
- 10.8. In case of matters requiring qualified majority, as



10.8. Në rastet kur kërkohet shumicë e kualifikuar sipas nenit 87 të Ligjit, te tilla si:

- Amendimi i Statutit;
- Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar;
- Shpërndarja e fitimeve;
- Riorganizimi dhe prishja e shoqërisë;

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse marrin pjesë në mbledhje ortakët që zotërojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar dhe vendosin me shumicën prej 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind) të votave pjesëmarrëse. Emërimi i një administratori do të kërkojë gjithashtu shumicë të kualifikuar sipas kësaj pike.

10.9. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 14 ditë, me të njëjtin rend dite.

10.10. Te gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e një kopjeje të tij.

10.11. Për sa kohë që kapitali themeltar i Shoqërisë do të zotërohet nga një ortak i vetëm, ky i fundit do të ushtroje të gjithë të drejtat dhe kompetencat e Asamblesë së Ortakeve sipas Ligjit dhe këtij Statuti.

#### Neni 11

##### Organi Administrues / Administratorët

11.1. Organi Administrues përbëhet nga jo më pak se 1 (një) dhe jo më shumë se 7 (shtatë) Administratorë që emërohen e shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ri-emërimi.

11.2. Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i vetëm i shoqërisë me mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi:

- **Z. Mesut Yilmaz**, shtetas turk, lindur më 27.9.1992 në Epinal, France e banues në Stamboll, Turqi, mbajtës i pasaportës me nr. Y20057471 dhe nr. Personal 45802106062.

11.3. Në vendimet për emërimin e administratorëve të tjerë, Asambleja e Përgjithshme do të përcaktojë edhe kompetencat e administratorëve dhe mënyrën e përfaqësimit të Shoqërisë. Administratori/et do të përfaqësojnë Shoqërinë sipas parashikimeve të këtij Statuti dhe sipas përcaktimeve të vendimeve të Asamblesë (Ortakut të Vetem) për emërimin e

per Article 87 of the Law, such as:

- Amendment of the Articles of Association,
- Increase or reduction of the registered capital,
- Profit distribution,
- Company's restructuring and dissolution,

the General Meeting of Partners may make valid decisions only if attended by the Partners or representatives of Partners holding 100% (one hundred percent) of the registered capital and shall decide with the majority of 75% (seventy five percent) of the participating votes. The appointment of a Managing Director requires also qualified majority as per this clause.

10.9. If the General Meeting of Partners could not be held due to lack of quorum, the meeting shall be reconvened within 14 days with the same proposed agenda.

10.10. All Assembly's resolutions should be recorded in the minutes. The Managing Directors are responsible for keeping a copy of the same.

10.11. For as long as the Company's basic capital shall be owned by a sole partner, the sole partner shall exercise all the rights and powers of the General Assembly based on the Law and this Articles.

#### Article 11

##### Managing Body / Managing Directors

11.1. The Managing Body consists of not less than 1 (one) and not more than 7 (seven) Managing Directors, which are appointed and dismissed by the General Assembly of Partners. The office term of the Managing Director shall be 5 (five) years with the right to be re-appointed.

11.2. The following person is appointed as first sole Managing Director of the company for a 5 (five) year term of office:

- **Mr. Mesut Yilmaz**, Turkish citizen, born 27.9.1992 in Epinal, France, resident of Istanbul, Turkey, bearer of the passport with no. Y20057471 and personal no. 45802106062.

11.3. In the resolutions for the appointment of other Managing Directors, the General Assembly shall define also the powers and representations of the Company by the Managing Directors. The Managing Director/s shall represent the Company in accordance with the provisions of this Articles and the provisions of the resolutions of the Assembly (sole partner) for their appointment.



administratorit/eve.

11.4. Administratori do të:

- (a) administroje veprimtarine tregtare të Shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
- (b) përfaqësojë Shoqërinë;
- (c) kujdeset për mbajtjen e rregullt të librave dhe dokumenteve kontabel;
- (d) përgatise dhe nënshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilat ia paraqet Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
- (e) krijojë një sistem njoftimi të përshtatshëm për rrethanat që mund të kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- (f) kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas kërkesave të Ligjit Tregtar apo të ligjeve të tjera të zbatueshme;
- (g) raportoje përpara Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe për perfundimin e transaksioneve që kanë një rëndësi të veçantë për performancën tregtare të Shoqërisë;
- (h) përfaqësojë shoqërinë përpara gjykatave;
- (i) kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në Ligjin Tregtar dhe në këtë Statut;
- (j) thërresë mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve sa herë që kërkohet sipas Ligjit apo këtij Statuti.

11.5. Administratori mund të autorizojë persona të tjerë për të vepruar në emër dhe për llogarinë e tij, duke specifikuar / përcaktuar kategorinë e akteve dhe veprimeve që përfaqësojë mund të kryejë.

11.6. Veç kufizimeve ligjore, nuk do të aplikohen kufizime të kompetencave të administrimit. Administratori ka kompetencën të plotë e të pakufizuar.

**Neni 12**  
**Kontrolli i Shoqërisë**

12.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të emërojë një ose disa eksperte kontabël të autorizuar për kontrollin e llogarive të Shoqërisë.

**KAPITULLI IV**  
**VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE,**  
**FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE**

**Neni 13**  
**Viti Financiar**

11.4. The Managing Director shall:

- (a) Manage the Company's business activities / operations by implementing the trade policies adopted by the General Meeting of Partners;
- (b) Represent the Company;
- (c) Ensure that the necessary accounting books and documents are duly kept;
- (d) Prepare and sign the balance sheet and consolidated balance sheet and the performance report and present it to the General Meeting of Partners for approval together with the proposals for the distribution of profits;
- (e) Create an adequate warning system with respect to circumstances threatening Company's existence;
- (f) Make mandatory registration and publication of Company's data as requested by the Companies' law and any other applicable law;
- (g) Report to the General Meeting of Partners with respect to the implementation of business policies and to the conclusion of transactions of particular importance for Company's performance;
- (h) Represent the Company in litigations;
- (i) Perform other duties set by the Companies' Law or this Articles of Association;
- (j) Convene the General Assembly of Partners when required by the Law or this Articles.

11.5. The Managing Director may authorize other persons to act in his name and on his behalf, specifying the category of acts and doings that such representative may carry out.

11.6. Apart from legal restrictions, no restrictions on the powers of the Managing Director will apply. The managing director has full and unlimited powers.

**Article 12**  
**Control of the Company**

12.1. The General Meeting of Partners may appoint one or more certified chartered accountants to control the Company's accounts.

**CHAPTER IV**  
**FINANCIAL YEAR, ANNUAL STATEMENTS OF**  
**ACCOUNT, PROFITS AND LEGAL RESERVE**

**Article 13**  
**Financial Year**



- 13.1. Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhjete) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.
- 13.2. Ne menyre perjashtimore, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

**Neni 14**  
**Rezerva Ligjore**

- 14.1. Shoqeria do te kaloje ne fondin rezerve te detyrueshem te paktën 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve te arrije vlerën e barabarte me 10 perqind te kapitalit themeltar.

**Neni 15**  
**Dividendet**

- 15.1. Pas miratimi te bilancit vjetor, Administratori do te propozoje shperndarjen e dividendëve te pagueshme secilit prej Ortakeve dhe Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te percaktojë shumen e fitimeve qe do t'i shpermdahet secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjesëtim me pjesën takuese ne kapitalin themeltar.

**KAPITULLI V**  
**PRISHJA - LIKUIDIMI**

**Neni 16**  
**Prishja e Shoqerise**

- 16.1. Shoqeria priset (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose (ii) ne rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimtari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne QKR; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) per arsye te tjera te parashikuara ne ligj.

**Neni 17**  
**Likuidimi**

- 17.1. Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.

**Neni 18**  
**Dispozita Perfundimtare**

- 13.1. The financial year has a 12 (twelve) months' duration commencing from the 1<sup>st</sup> of January and ending on the 31<sup>st</sup> of December each year.
- 13.2. Exceptionally, the first financial year begins on the date of registration of the Company in the Companies Register.

**Article 14**  
**Legal Reserve Fund**

- 14.1. The Company shall allocate at least 5% (five percent) of the annual net profit as a mandatory reserve fund until it reaches a value equal to 10% (ten percent) of the registered capital.

**Article 15**  
**Dividends**

- 15.1. After the annual balance sheet is approved, the Managing Director shall propose which dividends are payable to each partner and the General Meeting of Partners shall define the amount of profit that will be distributed to each of the Partners as dividend, proportionally to the respective shareholdings.

**CHAPTER V**  
**DISSOLUTION – LIQUIDATION**

**Article 16**  
**Dissolution**

- 16.1. The Company will be dissolved (i) by resolution of the General Meeting of Partners; or (ii) in case of bankruptcy; or (iii) if it fails to be active for 2 (two) years and the suspension of activity has not been notified to NCR; or (iv) by a court decision; or (v) for any other reason provided by the law.

**Article 17**  
**Liquidation**

- 17.1. Unless a bankruptcy procedure has been initiated, the dissolution of the Company brings about the commencement of the liquidation procedure.

**Article 18**  
**General provisions**







- 18.1. Te gjithë shpenzimet, kostot, tarifat dhe faturat e shërbimeve profesionale që lidhen me themelimin dhe regjistrimin e Shoqërisë, do të përballohen nga Shoqëria.
- 18.2. Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar.
- 18.3. Konfliktet ne lidhje me këtë Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrethit gjyqësor ne territorin e se cilës Shoqëria ka selinë e saj.
- 18.4. Me qellim shmangien e çdo paqartësie, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose çdo funksionari tjetër nuk do te konsiderohen si ndryshime te këtij Statuti.

Ky Statut nënshkruhet rregullisht ne 4 (katër) origjinale ne gjuhët Shqipe dhe Angleze.

**ORTAKU THEMELUES**

*Fatih CANKURT*

UNIVERSITY OF NEW YORK, TIRANA SHPK  
Përfaqësuar nga  
Fatih Cankurt



- 18.1. All expenses, costs, tariffs and fees of professionals, related to the incorporation and registration of the Company, shall be borne by the Company.
- 18.2. The provisions of Companies' Law will apply on all matters not regulated herein.
- 18.3. Disputes arising out of this Articles shall be settled by the court of the place where the Company's legal seat is located.
- 18.4. For the avoidance of doubt, changes of the Partners and/or Managing Director and/or any other official shall not be deemed as amendments to this Articles.

This Articles is duly executed in 4 (four) original copies in Albanian and English.

**FOUNDING PARTNER**

*Fatih CANKURT*

UNIVERSITY OF NEW YORK, TIRANA SHPK  
Represented by  
Fatih Cankurt





Faint, illegible text on the left side of the page, possibly bleed-through from the reverse side.

Faint, illegible text on the right side of the page, possibly bleed-through from the reverse side.

REPUBLIC OF INDONESIA

REPUBLIC OF INDONESIA

Signature of the official on the left side.

Signature of the official on the right side.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
Nr. 8381 Rep.



### VERTETIM NENSHKRIMI

Sot, ne Tirane, me date 4 shtator 2019 (dymije e nentembedhjete), perpara meje JULIAN ZHELEGU, noter prane Dhomes se Notereve Tirane, me seli ne adresen Rr. "Pjeter Bogdani", nr. 13, u paraqit:

- **z. Fatih Cankurt**, shtetas turk, lindur më 15.10.1988 në Hafik / Sivas, Republika e Turqisë, mbajtës i pasaportës me nr. Z00511731, njohës i gjuhës angleze, madhor e me zotësi te plote juridike për te vepruar, ne cilesine e Administratorit te shoqerise "**UNIVERSITY OF NEW YORK, TIRANA**" SH.P.K., një shoqëri tregtare me përgjegjësi te kufizuar, e themeluar e qe funksionon ne përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me NUIS-NIPT K21714002G, me seli ne Tiranë, Farke, Selite, Rruga "Kodra e Diellit", te "University of New York Tirana", zonë kadastrale nr. 3292, numër pasurie 103/17,

I cili nenshkroi me vullnet te lire e te plote dokumentin bashkelidhur, Statut i shoqerise "**Educational Investment and Consultancy**" Sh.P.K, dhe une noteri vertetoj nenshkrimin e tij ne rregullisht sipas ligjit.

NOTER  
JULIAN ZHELEGU

